

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Fillon plani i riadhesimit për qytetarët shqiptarë jashtë vendit



Pas grupit të parë të riadhesimeve të kryer para pak ditësh, shteti shqiptar fillon operacionin e dytë të riadhesimit për të gjithë qytetarët shqiptarë, të cilët për shkak të pandemisë kanë mbetur jashtë vendit. Planin e riadhesimit do të fillojë ditën e shtunë më 18 prill nga Roma, për të vazhduar më pas me disa vende të tjera të Evropës si: Milano, Bari, Frankfurti, Parisi, Londra, Stambolli. Të gjithë emigrantët do të akomodohen për 14 ditë në disa hotele në Durrës, të cilat janë transformuar në struktura karantinimi COVID-19. Procesi i riadhesimit që nga hoteli i karantinimit, çmimi i akomodimit si dhe çmimi i biletës së avionit do të realizohet përmes rubrikës riadhesime në faqen e "Air Albania". Për të kryer rezervimin e paketës së riadhesimit dhe hapat që duhet të ndjekin qytetarët e interesuar për t'iu riadhesuar nga vendet e BE-së, klikoni [këtu](#).

Mbahet mbledhja e Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën



U zhvillua mbledhja e Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, i cili është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë". Në mbledhje ishte i pranishëm edhe zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, z. Jusuf Thaçi, i cili përveç shprehjes së gatishmërisë për vijueshmërinë e punës së nisur nga ky Komision, vuri theksin në një qasje të bashkëkohore në hartimin e materialeve mësimore për mësimdhënien e gjuhës shqipe në diasporë, duke përfshirë platformat digjitale, të cilat lehtësojnë procesin e mësimdhënies për shqiptarët në të gjithë botën. Anëtarët e këtij komisioni, përfaqësues nga institucionet e Diasporës së Republikës së Shqipërisë, Drejtoresha e Kabinetit të Ministrisë të Shtetit për Diasporën Etleva Kondi, Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën Mimoza Hysa; përfaqësues nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës, Shqipe Gashi, Arbër Salihu; përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Shqipërisë, Erida Koleci, Majlinda Hala dhe Evis Mastori, diskutuan për problematikat e hasura deri tani në punën e këtij komisioni dhe për mënyrën e procedimit në të ardhmen. Për shkak të situatës së krijuar, takimi u zhvillua online.

KKD / Mark Gjonaj flet për situatën e komunitetit shqiptar



Mark Gjonaj, Kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht këshilltar i Bashkisë së New York-ut, flet për situatën dhe vështirësitë e krijuara nga pandemia COVID-19 edhe për komunitetin shqiptaro-amerikan në New York. Ai konfirmon se numri i rasteve të prekura me koronavirus është rritur edhe në komunitetin e Diasporës shqiptare, ku ka pasur edhe viktima. Z. Gjonaj përmend dhe një ndër amanetet e bashkatdhetarëve, të cilët ndahen nga jeta larg atdheut: "Nëse vdes, trupin ma ktheni në vendlindje".

KKD / Visar Tasimi tregon për gjendjen nga COVID-19




Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, Visar Tasimi, në një intervistë të dhënë tregon se si po e përjeton situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 komuniteti shqiptar në Connecticut. Sipas tij, nga komuniteti shqiptar deri më tani nuk janë raportuar viktima, por vetëm të infektuar. Ndërkohë, ai tregon se në qytetin e New York raportohet të ketë viktima nga komuniteti shqiptar, ndërsa ky qytet është një nga më të goditurit nga koronavirusi. Tasimi, gjithashtu, tregoi dhe për vendimin e Këshillit Koordinues të Diasporës për t'i ardhur në ndihmë shqiptarëve të bllokuar në Kapshticë. "Këshilli i Diasporës është shumë i ndjeshëm ndaj situatave të tilla. Ne ishim në komunikim të vazhdueshëm me njeri-tjetrin dhe menduam se duhet ta benim këtë gjë", u shpreh ai.

KKD / Libri i Kapllanit në mesin e librave më të mirë frëngjisht



Libri i përkthyer në disa gjuhë "Ditar i shkurtër kufijsh" i autorit Gazmend Kapllani gjendet në listën e librave më të mirë frëngjisht në Bibliotekën Publike të Nju-Jorkut. Me rastin festimit të Javës së Trashëgimisë së Emigrantëve 2020, Biblioteka u ofron lexuesve një listë librash elektronikë të autorëve më të vlerësuar.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Hapat për procesin e riadhesimit të qytetarëve shqiptarë

- Hyr në faqen e **Air Albania** www.airalbania.com.al në rubrikën **RIADHESIME**
- Prenoto Hotelin** e karantinimit dhe bëj pagesën online sipas formularit që do të paraqitet **7 Euro/ditë**
- Me kodin e hotelit, që do t'ju vijë në email kthehu në faqen e **Air Albania** dhe **prenoto biletën**
- Me konfirmimet e hotelit dhe biletës, paraqituni në aeroport në datën, që do t'ju njoftohet nga **Air Albania**
- Me mbërritjen në **Shqipëri** do të shoqëroheni në hotelin e rezervuar, ku do të karantinoheni për **14 ditë**
- Për çdo paqartësi apo informacion të mëtejshëm drejtohuni në numrat **+355 4 224 60 00**, **+355 69 80 47 619**, **+355 69 80 47 633**, **+355 69 80 47 625**